REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2018:010556
Datë:	27.12.2018
Numri i dokumentit:	00197182

P.nr.774/2017

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve M.B dhe M.P, të dy na Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkë kryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale në bashkë kryerje të sulmit nga neni 187 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.409-1/2017 të datës 06.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarve, me datë 09.11.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit

1. M.B, nga i ati Xh. dhe nëna Xh. e lindur O., i lindur me datë ... në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga "...", pa numër, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. M.P, nga i ati Shukri dhe nëna R. e lindur D., i lindur me datë .. në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga ..", nr...., ka të kryer shkollën fillore, këpuctar, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

I.Me datë 13.12.2016, rreth orës 22,30 minuta, në Prizren, në rrugën "...", në bashkë kryerje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit R.A, të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohshmen të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje që kishte pasur në mes vete, i dëmtuari R.A me Y.G(këtu dëshmitar), si shenjje hakmarrje për mosmarrëveshjen e tyre, dy të pandehurit e sulmojnë fizikisht duke e goditur me grushte të dëmtuarin R.A, të njëjtit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, lëndime

2018:010557

këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertrit mjeko ligjor dr. Musa Gashi të datës 29.03.2017,

Kësodore kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës,

I akuzuari M.B,

II.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I, të kësaj aktakuze në bashkë kryerje me dashje përdorin forcën ndaj të dëmtuarit S.A, pa pëlqimin e tij, në atë mënyrë që për shkak të rrethanave të lartë cekura si në dispozitivin nën I, i dëmtuari S.A ishte në shoqëri me vëlaun e tij, të dëmtuarin R.A, pasi u mundua ti ndaj nga zënga me të pandehurit, i njëjti e sulmojnë me grushte, mirëpo nuk i shkaktojnë lëndime trupore,

Kësodore ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës,

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75, 76 dhe neni 187 par.1 të KP-ës, te akuzuarve ju shqipton:

Të akuzuarit M.B:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale

Të akuzuarit M.P

DËNIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do e ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësore secili veç e veç të paguaj shumen prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.409-1/2017 të datës 06.04.2017, kundër të akuzuarëve M.B dhe M.P, të dy na Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkë kryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale në bashkë kryerje të sulmit nga neni 187 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Sahide Sefa, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj pranë aktakuzës PP.II.nr 409-1/17 të datës 06.04.2018, të përmirësuar në shqyrtimin fillestar me datë

2018:010557

10.04.2018, kundër të akuzuarve M.Bdhe M.P, të dy na Prizreni, për shkak të veprave penale dhe ate veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkë kryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale në bashkë kryerje të sulmit nga neni 187 par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin e sotëm në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprat penale si në aktakuzë të përmirësuar, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë

I akuzuari i parë M.B në fjalë e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprat penale cila më vihet në barë, pendohem thellë për veprat e kryera më vije keq për rastin e ndodhur, si dhe i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mija personale, moshën time, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin e lartësinë e dënimit.

I akuzuari M.P, në fjalën e tij përfundimtare deklaron, e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, edhe pse unë kam ndërhyrë paraprakisht që ti ndaj shokun tim M.B, me këtu të dëmtuarit, mirëpo pasi që gjatë kësaj ndarje ka ardhur ndoshta edhe te ndonjë goditje apo sulm ndaj palëve të dëmtuara edhe nga ana ime, ashtu siç e ka kualifikuar prokuroria, i pranoj veprat penale si në dispozitivin nën I të aktakuzës të lëndimit të lehtë trupor edhe po ashtu si nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës të sulmit, por i propozoj gjykatës që pranimin i fajësisë për veprat penale të cekura më lart, rrethanat e mija personale, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I.Me datë 13.12.2016, rreth orës 22,30 minuta, në Prizren, në rrugën "...", në bashkë kryerje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit R.A, të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohshmen të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje që kishte pasur në mes vete, i dëmtuari R.A me Y.G (këtu dëshmitar), si shenjje hakmarrje për mosmarrëveshjen e tyre, dy të pandehurit e sulmojnë fizikisht duke e goditur me grushte të dëmtuarin R.A, të njëjtit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertrit mjeko ligjor dr. Musa Gashi të datës 29.03.2017,

I akuzuari M.B,

II.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I, të kësaj aktakuze në bashkë kryerje me dashje përdorin forcën ndaj të dëmtuarit S.A, pa pëlqimin e tij, në atë mënyrë që për shkak të rrethanave të lartë cekura si në dispozitivin nën I, i dëmtuari S.A ishte në shoqëri me vëlaun e tij, të dëmtuarin R.A, pasi u mundua ti ndaj nga zënga me të pandehurit, i njëjti e sulmojnë me grushte, mirëpo nuk i shkaktojnë lëndime trupore,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston

2018:010557

ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoi dënimet e cekura më lart, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjellja korrekte e tyre pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tyre, gjer më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, janë persona familjar, dhe ate i akuzuari i parë Ushtrim Shala, është baba I një fëmiu, ndërsa i akuzuari I dytë meriman Ukaj, është baba i dy fëmijve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarve me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, shprehja e keqardhjes të akuzuarve për veprat penale të shkaktuara, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit si dhe pas veprave penale të shkaktuara, gjendjen e tyre ekonomike, andaj gjykata ju shqiptoi dënimet veç e veç dhe ate të akuzuarit të pare Ushtrim Shala, për veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-ës, dënimin me kusht, duke vërtetuar dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryer vepër të re penale, dhe të akuzuarit të dytë Meriman Ukaj, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-ës, duke vërtetuar dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryer vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:010556, 27.12.2018

Procesmbjatesja **Gjyqtari,**
Nacis Sarani **Luan Berisha**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

2018:010557